



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028 në fshatin Lluzhan

Data: 03.06.2025

Podujevë

Të dhënat e përgjithshme

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutit të Komunës së Podujevës, dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri më datë 20.06.2025 në emailin: info.podujeva@rks-gov.net

Procesverbali është një dokument publik, i hartuar sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Hartuesi i procesverbalit ka redaktuar të dhënat personale të palëve që janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara kanë qasje në këto të dhëna, të cilat janë të arkivuara në komunë.

Dokumenti përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit, përmbledhjen e takimit dhe në aneks përfshihen materialet e bashkëngjitura të grumbulluara gjatë takimit.

Veprimet para nisjes së takimit

Para nisjes së diskutimit, të pranishmit janë regjistruar në listën e pjesëmarrësve duke ofruar emrin, mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen në dëgjimet publike të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB).

Është konstatuar se për këtë takim nuk ka pasur nevojë për përkthyes apo interpret për persona me aftësi të kufizuara.

Zhvillimet gjatë takimit

Takimi filloi në ora 18:05.

Të pranishëm ishin:

- ***Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani***
- ***Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Shuaib Blakçori***
- ***Zyrtarja nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim***

Morën pjesë gjithsej 9 persona (të gjithë burra).

(Shih në aneks: fotografitë dhe lista e pjesëmarrësve)

Fjalimi hyrës nga drejtori i Financave

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Fatlum Osmani, hapi zyrtarisht dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028, në ambientet e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Afrimi e Fahriu” në fshatin Lluzhan.

Përmbledhje nga fjalimi:

“Të nderuar qytetarë, në emër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, hap zyrtarisht dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 për Komunën e Podujevës.

Kjo Kornizë është një dokument strategjik që përcakton prioritetet financiare të komunës në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe objektivat zhvillimore.

Përgatitet në harmoni me Qarkoren Buxhetore 2026/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, e cila përcakton udhëzimet dhe kufijtë fillestarë për hartimin e buxhetit.

Qarkorja përfshin udhëzime për buxhetin e vitit 2026 dhe projeksionet për vitet 2026–2028, duke u bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë, stabilitetin fiskal, reformat ekonomike dhe integrimin evropian (MSA, Programi për Reforma në Ekonomi).

Theksohet rëndësia e orientimit të shpenzimeve drejt prodhimit, punësimit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe transformimit digjital.”

Limite buxhetore për vitin 2026 për Komunën e Podujevës:

- ***Granti i përgjithshëm: 14,627,269 €***
- ***Granti për arsim: 13,690,040 €***
- ***Granti për shëndetësi: 3,687,591 €***
- ***Shërbimet rezidenciale: 230,000 €***
- ***Financimi i teatrove: 185,729 €***
- ***Të hyrat vetanake: 2,358,325 €***

Totali i planifikuar: 34,778,954 €

Prioritetet e KAB-it Komunal 2026–2028 përfshijnë:

- *Ngritjen e cilësisë së arsimit dhe lidhjen me ekonominë*
- *Zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe rurale*
- *Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore*
- *Zhvillimin ekonomik vendor dhe bujqësor*
- *Barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale*
- *Planifikimin shumëvjeçar të projekteve kapitale*

Korniza është hartuar sipas strukturës kontabël dhe parimeve të buxhetimit të orientuar drejt performancës, duke përfshirë indikatorë gjinorë dhe të rezultateve për secilin program.

“Të nderuar pjesëmarrës, ky dëgjim publik është mundësi që secili prej jush të japë kontributin në përmirësimin dhe përfaqësimin e drejtë të prioriteteve buxhetore. Vetëm përmes pjesëmarrjes suaj të drejtpërdrejtë, mund të ndërtojmë një buxhet realist, të drejtë dhe gjithëpërfshirës.”

Pas përfundimit të fjalimit, drejtori Osmani hapi diskutimin me pjesëmarrësit për të marrë kërkesat dhe komentet e tyre.

Kërkesat nga pjesëmarrësit në dëgjim publik

Sefer Bunjaku:

- *Ndriçim publik në fshatin Sallabajë (disa zona pa ndriçim)*
- *Ndërtimi i trotuareve në lagjen e Bunjakëve*
- *Ndërtimi i një shkolle të re*
- *Rregullimi i hapësirës për të pame pranë objektit përkatës*

Sadik Durmishi:

- *Shpreh falënderime për punën e Komunës dhe drejtorëve*
- *Kërkesë për ndriçim publik mes rrugës “Fronti” dhe “Vëllezërit Musliu”*
- *Vazhdimi i trotuarit nga rruga “Malësia e Bungut” deri në fund të saj*
- *Pyet për kontratë për kanalizim në Godishnjak për dy familje*

Naim Çunaku:

- *Shkolla ka mungesë të mjeteve konkretizuese*
- *Nevojë për edukim qytetar dhe qytetari aktive*
- *Banorët e Llugave përballen me përmytje – kërkohet rregullimi i shtratit të lumit*

Xhevdet Maloku:

- *Ndriçim publik*
- *Përgjigje për çështjen e hapësirës për të pame: pengesë janë ndërhyrjet e banorëve, jo mungesa e interesimit nga Komuna*
- *Vazhdimi i rrjetit të kanalizimit të “Mehdi Bici”*
- *Trotuar nga Sallabaja te Bici e deri në Lluzhan*
- *Vendosje e policëve të shtrirë në Lluzhan për shkak të rrezikut nga shpejtësia*
- *Problemi i rrugës magjistrale dhe mungesa e rrethrotullimit – janë bërë tri peticione nga banorët, mbetet shpresë për përgjigje nga Ministria*

Nebih Musliu:

- *Nevojë për gypa në Lluzhan për të parandaluar dëmtimin e rrugës*
- *Kërkon më shumë punë dhe angazhim*

Sefer Bunjaku (sërish):

- *Ka pak projekte të realizuara në Sallabajë*
- *Kërkon më shumë investime, sidomos për përfundimin e trotuarit*

Drejtori Osmani u përgjigj në disa nga pyetjet dhe njoftoi se pas përfundimit të të gjitha dëgjimeve, do të hartohet raporti përmbledhës me të gjitha kërkesat e qytetarëve, i cili do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Mbyllja e takimit

Takimi përfundoi në ora 19:15.

Në këtë dëgjim publik morën pjesë gjithsej 9 persona, me 15 kërkesa të regjistruara.

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve sipas gjinisë

Gra	0
Burra	9
Totali	9

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, në fshatin Lluzhan

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	Xhevdet Maloku	LLUZHAN	
2.	LIJAN DALLA	LLUZHAN	
3.	XHAVIT SADIKU	BRAIN	
4.	SEFER DUKAJAKU	SALLABAT	
5.	N. Gjin MUSLIU	LLUZHAN	
6.	Blendi GURPASHI	LLUZHAN	
7.	Shqipëri Blagani	LLUZHAN	
8.	KORÇIS KALON	LLUZHAN	
9.	ASDRENI LLIGANU	LLUZHAN	
10.	SADIK DURNISHI	SALLABAT	
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			

Podujevë: 03.06.2025

